

ARTIKULLI #7

PROFESORË NGA USI UDHËHEQIN PUNËTORI PËR KLASË ME MËSIMNXËNIE NË QENDËR PËR PROFESORËT KOSOVAR.

JULY 5, 2023

Për më shumë foto mbi këtë artikull, shkoni në link:

<https://drive.google.com/drive/folders/1wiOJegr8OgpCBe56Bv4vx6yJl5rdL6GQ>

Aktiviteti Partneritetet e Sektorit Privat për Forcimin e Arsimit të Lartë, i financuar nga USAID dhe implementuar nga Universiteti i Iowa, Universiteti Shtetëror i Iowa, dhe Qendra për Arsim e Kosovës (KEC), është i përkushtuar në pajisjen e stafit të universiteteve publike në Kosovë me veglat, sistemet dhe ekspertizën e nevojshme për të përgatitur efektivisht studentët e Bujqësisë dhe TIK për tregun e punës. Si pjesë e kësaj iniciative, profesorët e nderuar Dr. Jan Wiersema dhe Dr. Curt Youngs nga Kolegji i Bujqësisë dhe Shkencave të Jetës në Universitetin Shtetëror të Iowa (USI) lehtësuan një seri të punëtorive trajnuese mbi ofrimin e Klasëve me Mësimnxënie në Qendër për studentët universitar.

"Ndihehem i ngazëllyer të prezantoj kolegën time të nderuar, Dr. Jan Wiersema nga USI, për të lehtësuar një punëtor mbi metodat inovative të mësimdhënies. Kanë kaluar tetë vite nga koha kur kisha nderin që të ndjek kursin transformativ të Jan mbi Klasët me Mësimnxënie në Qendër, i cili luajti një rol kyç në riformimin e qasjes sime ligjëruese si profesor. Mezi pres që t'ua jap këtë mundësi të jashtëzakonshme kolegëve tanë profesorë në Kosovë, duke u mundësuar atyre të përfitojnë nga ekspertiza e Jan, dhe të pasurojnë tutje praktikën e tyre të mësimdhënies." – **Dr. Curt Youngs, Specialist për Bujqësi i Aktivitetit dhe Profesor Morrill në Universitetin Shtetëror të Iowa.**

Këto punëtori, me kohëzgjatje dy ditë secila, u zhvilluan ndarazi në secilin universitet partner me aktivitetin: Prishtinë, Pejë dhe Prizren. Pjesëmarrësit përfshinë profesorë, trajnerë të lartë nga Qendrat për Përsosmëri në Mësimdhënie, dhe staf administrativ të universiteteve nga departamentet e TIK dhe Bujqësisë.

Sesionet e trajnimeve u fokusuan në teori të mësimnxënies dhe mësimdhënies, duke u ofruar një mundësi pjesëmarrësve që në mënyrë kritike të ekzaminojnë besimet e tyre rreth mësimnxënies. Përmes angazhimit në aktivitete të ndryshme, ata/ato u inkurajuan të reflektojnë mbi të menduarit e tyre dhe proceseve të mësimnxënies. Duke përjetuar strategji me qendër mesimnxënien, pjesëmarrësit eksploruan implikimet dhe aplikimet praktike në dizajnimin e përvojave efektive të mësimnxënies për studentët.

"Punëtorja ishte jashtëzakonisht e dobishme! Ajo na mundësoi njohuri kolektive mbi udhëheqjen e mësimnxënies së studentëve. Në botën e sotme dinamike, ku vëmendja është gjithmonë e më e shkurtër, angazhimi i tyre dhe nxitja e të menduarit në mënyrë kritike në klasë është bërë një sfidë e madhe për profesorët në gjithë botën. Prandaj, mundësia për të mësuar rreth aktiviteteve, teknikave dhe strategjive për t'i bërë pjesë të agjendave tona të mësimdhënies, për të përmirësuar angazhimin e studentëve vërtetë vlerësohet shumë. Ne jemi me fat të bashkëpunojmë me studiues me përvojë nga Universiteti Shtetëror i Iowa, për të adresuar sfidën e vëmendjes së studentëve dhe për të promovuar mësimnxënien efektive. Ekspertiza e tyre

është e paçmueshme!"- Shyhrete Muriqi, Asistente Profesoreshë, Fakulteti i Agrobiznesit, Universiteti Haxhi Zeka, Pejë.

*"Pika kulmore e kësaj punëtorie ishte theksi në krijimin e komunitetit të fortë në klasë. Jam shumë mirënjohëse për mundësinë që të zbuloj teknika, metodologji dhe praktika të reja efektive të cilat promovojnë marrëdhënie të fuqishme mësimitdhënës-student, duke kultivuar kështu një ambient optimal për mësimitdhënies kolektive. Punëtorja vërtetë më ka inspiruar të përmirësoj qasjen time të mësimitdhënies, t'u mundësoj studentëve të angazhohen në mendim më të thellë dhe nxitje të mendimit kritik, kreativitetit, dhe lirisë së shprehjes."***Blerta Mehmedi Kastrati, Asistente Profesoreshë në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë**

"Pjesëmarrja në këtë punëtori ishte një përvojë e këndshme. Si profesoreshë e dedikuar dhe trajnere në Qendrën për Përsosmëri në Mësimitdhënies në Universitetin e Prizrenit, unë vazhdimisht kërkoj mënyra për të trajnuar stafin akademik në përmirësim të metodave të tyre të mësimitdhënies për angazhim dhe edukim më efektiv të studentëve. Këshillat e Profesoreshës Jan në zhvendosjen e fokusit nga përmirësimi i mësimitdhënies tonë në lehtësim të të mënduarit kritik dhe mësimitdhënies, rezonoi shumë në mua. Praktikrat që i eksploruam gjatë punëtorisë do të kenë ndikim afatgjat në qasjen time, duke më mundësuar të dizajnoj klasë që i hapin rrugë mësimitdhënies më efektive bashkëpunuese dhe të mënduarit kritik mes studentëve" – **Mirvjena Kortoçi, Profesoreshë e Asociuar në Universitetin e Prizrenit, Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit.**

Këto punëtori shënojnë një hap të rëndësishëm përpara në rritjen e aftësive pedagogjike të stafit të universiteteve publike të përfshirë në projekt. Aktiviteti Partneritetet e Sektorit Privat për Forcimin e Arsimit të Lartë është i përkushtuar në nxitjen e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të njohurive mes universiteteve publike në Kosovë, Universitetit Shtetëror të Iowas dhe Universitetit të Iowas, duke siguruar kështu që studentët në fushat e Bujqësisë dhe TIK të fitojnë përgatitjen më të mirë të mundshme për sukses në tregun e punës.

"Duhet një jetë e tërë e përkushtimit për të zotëruar artin dhe shkencën e të ndihmuarit të tjerëve. Ngjashëm me hulumtuesit e psikologjisë kognitive, të cilët vazhdimisht përpiqen të zbulojnë misteret e të mënduarit njerëzor, edukatorët janë mësimitdhënës të përherëshëm, gjithmonë në kërkim të përmirësimit të kuptimit të tyre se si të lehtësojnë dhe udhëzojnë procesin mësimit në mënyrë efektive. Duke pasur mundësinë të punoj përkrah profesorëve në Kosovë, u frymëzova thellësisht nga motivimi dhe vendosmëria e tyre për t'u shërbyer studentëve të tyre duke u kujdesur për secilin individ.

Dëshmimi i gatishmërisë së tyre për të nisur një rrugëtim jetëgjatësor të rishikimit dhe përsosjes së planeve dhe strategjive të tyre të mësimitdhënies, me synimin për të krijuar përvoja mësimore tërheqëse, frymëzuese, dhe qëllimore për studentët e tyre, më mbushi me gëzim dhe kënaqësi të pamasë." – **Dr. Jan Wiersema, Profesoreshë e Asociuar e Edukimit, USI**